



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:282791

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06287477

C.nr. 1063/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Nehat Qelaj, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.K.nga fshati L., Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Krasniqi & Partners” Sh.P.K., (av. Xhevdet Krasniqi etj), me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me adresë në Prishtinë, 10 000, Rr. “Luan Haradinaj”, nr. 99, të cilën e përfaqëson avokatja shtetërore Nazmije Aliu nga avokatura shtetërore e Kosovës, me objekt kompensimin e shpenzimeve ushqimit (shujtave) në punë, shpërblimi jubilar si dhe pagën shtesë (pagën e 13-të), në vlera prej 5,591.00 Euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 11.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Z.K.nga fshati L., Komuna e Malishevës, ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me adresë në Prishtinë, 10 000, Rr. “Luan Haradinaj”, nr. 99, që paditësit t’ia paguaj në ekuivalencë të një page mujore në lartësi prej 531.90 Euro, pagën e 13-të, për tre (3) vitet (2019, 2020, si dhe vitin 2021), në shumën e përgjithshme prej 1,595.70 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë më datë 23.12.2022, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit t’ia paguaj shumën prej 125.00 Euro, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR PJESA TJETËR e kërkesëpadisë së paditësit Z.K.nga fshati L., Komuna e Malishevës, mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi që përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2019 e deri më datën 31.12.2022, gjithsej 927 ditë pune, duke llogaritur nga 2.00 Euro, në shumë totale prej 1,854.00 Euro, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës), lidhur me kërkesën për pagesën shtesë që paditësi i ka kërkuar që të paguhet në ekuivalencë të një page mujore në lartësi prej 754.60 Euro, pagën e 13-të, për vitin 2022, diferenca në pagën e kërkuara shumen prej 222.70 Euro, si dhe në emër të një (1) pagave jubilarë për 10 vite përvojë pune shumën prej 754.60 Euro, në shumën e përgjithshme prej 3,585.90 Euro.

### A r s y e t i m

Paditësi Z.K.nga fshati L., Komuna e Malishevës, në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi më datë 23.12.2022, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me objekt kompensimin e shpenzimeve ushqimit (shujtave) në punë, shpërblimin jubilar në lartësinë e dy pagave si dhe pagën shtesë (pagën e 13-të) për vitet nga 2020, 2021 si dhe vitin 2022, në vlerë prej 5,591.00 Euro.

#### *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse.*

Paditësi të cilin e përfaqëson shoqëria e avokatëve “Krasniqi & Partners” Sh.P.K., (av. Xhevdet Krasniqi etj) me seli në Prishtinë, më tej kanë theksuar se ka të lidhur kontratë pune për kohë të pacaktuar me të paditurën - Policinë e Kosovës, në pozitën e Zyrtarit Policor që nga data 17.01.2005. I njëjti ka pasur performancë shumë të mirë për periudhën nga viti 2019, 2020, 2021 e deri 2022 dhe nuk ka marrë asnjë vërejtje nga punëdhënësi. Nga vërtetimi për punësim vërtetohet periudha e punësimit si dhe nga lista e pagave për të njëjtat vite, rezulton se paga e paditësit është në lartësi prej 754.60 Euro. Sa i përket ditëve të punës është e provuar në bazë të pasqyrës së ditëve të punës nga sistemi (PRIMS), për të cilat po kërkohet kompensimi i shujtës për periudhën pas datës 01.01.2019 e deri më 31.12.2022, ku në total del të ketë paditësi 927 ditë pune, gjithashtu paditësi i takon shpërblimi jubilar ashtu që për 20 vite përvojë pune, i takojnë një (1) paga nga 754.60 Euro apo në shumën e përgjithshme prej 1,063.80 Euro sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Nga Udhëzimi Administrativ nr. 02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i datës 14.11.2018, kur edhe ka hyrë në fuqi, në nenin 29 par. 1 dhe par. 2 është paraparë që personelit të policisë, të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda

vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Padiësi ka parashtruar kërkesë tek punëdhënësi për kompensim të shujtave ditore duke filluar nga data 01.01.2019 e deri në pagesën përfundimtare dhe pagesë të një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të çdo viti kalendarik duke filluar nga viti 2019 e deri në pagesën përfundimtare, mirëpo e paditura nuk është përgjigjur fare në këtë kërkesë të padiësit, duke e injoruar në tërësi të njëjtën. Andaj, padiësi në këtë situatë të ndodhur në pamundësi të realizimit të të drejtave të tij ka parashtruar këtë padi, ku ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të ushqim në punë (shujtës) vlerën prej 2.00 Euro, për 927 ditët e kaluara në punë dhe atë në total shumë prej 1,854.00 Euro ( $927 \times 2\text{€} = 1,854.00 \text{€}$ ), si dhe në emër të pagesës së 13-të, një page mujore ekuivalente për çdo fund të vitit duke filluar nga viti 2019, 2020, 2021 dhe viti 2022 t'ia paguaj shumën prej 2,982.40 Euro ( $4 \times 754.90 \text{€} = 2,982.40 \text{€}$ ), si dhe në emër të një pagave jubilarë për 10 vite përvojë pune shumë prej 754.90 Euro e të gjitha këto me kamatë prej 8% në vit duke filluar nga dita kur kërkesat kanë arritur për përmbushje e deri në pagesën përfundimtare, e të gjitha po ashtu në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar nga e paditura dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 Euro, për precizimin e padisë 104.00 €, si dhe për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 21.00 Euro, në shumë të përgjithshme prej 229.00 Euro.

E paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson avokatja shtetërore Nazmije Aliu nga avokatura shtetërore e Kosovës, në përgjigjen në padi të datës 25.09.2023, ka theksuar se e kundërshtojë në tërësi padinë e padiësit si të pabazuar, për shkak të mos shtjerrës së procedurave të brendshme nga padiësi tek e paditura, për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës brenda institucionit dhe parashkrimin e paditura kundërshton kërkesëpadinë e padiësit. Padiësi nuk ka shtjerr mjetet juridike të nenit 78 par. 1 dhe par. 2 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, në të cilin parashihet se i punësuari është i detyruar që të paraqesë kërkesë tek organi kompetent i punëdhënësit, i cili ka për detyrë të vendos brenda 15 ditësh, çka rezulton se në këtë rast padiësi nuk i ka shtjerrur këto mjete të brendshme. Sa i përket kërkesë për pagën e 13-të si dhe shpenzimet e ushqimit e kundërshtojë, kjo pasi që e njëjta nuk është realizuar për asnjë punonjës të policisë, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, edhe pse pohon faktin se Policia e Kosovës ka dorëzuar kërkesë Ministrisë së Financave në vitin 2017, ku kjo e fundit nuk e ka aprovuar kërkesën dhe si rrjedhojë e kësaj nuk janë përmbushur detyrimet e parapara në UA.nr. 02/2018, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Gjithashtu sa i përket

kërkesës për shpërblim jubilar bazuar në nenin 341 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve është e parashkruar, pasi që paditësi ka filluar punën 17.01.2005 dhe në vitin 2015 i ka bërë 10 vite përvojë pune ndërsa 20 vite përvojë pune i bënë në vitin 2025. E paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor ka përmbushjen e kontratës së punë e cila konsiderohet ligj për palët dhe se deri më tani nuk ka mundësi institucionale ligjore dhe financiare për pagesën e këtyre detyrimeve nga e paditura, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës e paditura nuk është deklaruar.

*Gjendja faktike e vërtetuar si dhe provat e administruar.*

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kërkesën për pagesën e shujtave dhe pagës së 13 të dorëzuar nga paditësi tek e paditura pa protokoll, e datës 19.12.2022; Kopjen e ID-ve (letërnjoftimit dhe kartës së identiteti të zyrtarit policor); Vërtetimin e punësimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga DRP Gjakovë; Formularët e Vlerësimit të Përformancës për periudhat (01.01.2020 – 31.12.2020, 01.01.2021 – 31.12.2021 si dhe 01.01.2022 – 31.12.2022); Listën e pagave të muajit dhjetor në vitet 2021 e deri në vitin 2022, si dhe Kalendarin e ditëve të angazhuara në punë për periudhën 01.01.2019 e deri më datën 31.12.2022, gjithsej 927 ditë pune.

Gjykata konstaton se për palët ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësit kanë pasur të themeluara marrëdhënien e punës me të paditurën në pozitën e zyrtarit policor kjo është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilave gjykata iu fali besimin e plotë, duke u bazuar në kopjen e ID-ve (letërnjoftimit dhe kartës së identiteti të zyrtarit policor), vërtetimin e punësimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga DRP Gjakovë, me nr. .../SRR-NJBNI-..., si dhe formularët e Vlerësimit të Përformancës për periudhat (01.01.2019 – 31.12.2020, 01.01.2021 – 31.12.2021 si dhe 01.01.2022 – 31.12.2022).

Nuk ishte kontestues fakti që paditësi është i punësuar tek e paditura si dhe gjatë periudhës së viteve 2019 – 2022 i njëjti kishte raport të vlerësimit të kënaqshëm, po ashtu nuk ishte kontestues as fakti që paditësi ka pasur pagën në lartësi prej 531.90 Euro, për një muaj kalendarik, pasi që një gjë të tillë gjykata e ka vërtetuar në bazë të listës së pagave të muajit dhjetor në vitet 2019 e deri në vitin 2022, si dhe në bazë të vërtetimin e punësimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga DRP Gjakovë, me nr. ...SRR-NJBNI-..., nga e cila ka rezultuar se paditësi ka realizuar paga në vlera të ndryshe në fund të çdo viti të cekura më lart.

Gjithashtu për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues as fakti që paditësi për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri më datën 31.12.2022, kishte prezantuar në punë për 927 ditë.

Kontestues ishte fakti që paditësi nuk i ka shtjerrur mjetet juridike të cilat parashihen në ligjin e punës.

Gjykata e vërtetoi këtë fakt se paditësi i ka shtjerrur të gjitha mjetet juridike duke u bazuar në kërkesën për pagesën e shujtave dhe pagës së 13 të dorëzuar nga paditësi tek e paditura më datë 19.12.2022, me ç'rast vije në përfundim se paditësi i ka shtjerrur të gjitha mjetet e brendshme të të paditurës, edhe pse nuk ka prova në shkresat e lëndës që paditësi të ketë pranuar ndonjë përgjigje nga e paditura.

Gjykata përmes vërtetimit të punësimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga DRP Gjakovë, vërtetoi faktin se paditësi për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 531.90 Euro për një muaj kalendarik. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2019, 2020, dhe 2021 gjykata vërtetoi faktin se paditësi për vitin 2018 paditësi ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, për vitin 2019 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, për vitin 2020 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 4, si dhe për vitin 2021 ka pasur vlerësim të përgjithshëm me notën 5, gjë që në këtë rast këto nota korrespondojnë me vlerësimin i kënaqshëm, në bazë të së cilave paditësi mund të përfitojë pagën e 13-të, siç parashihet në udhëzimin administrativ.

Në bazë të vërtetimit të punësimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga DRP Gjakovë, me nr. 04/01-08/SRR-NJBNJ-845/2022, nga e cila ka rezultuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën që nga data 17.01.2005, nga çka rezulton se deri në ditën e paraqitjes së padisë i njëjti kishte 17 vite përvojë pune.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës.*

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, parashtresën për precizimin e padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 7, 8, nenit 147, lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim kryesor të çështjes ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 03/L-212 i Punës si dhe dispozitat e Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, i datës 21.01.2019 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, si dhe Udhëzimin Administrativ (UA) nr.01/2021 i datës 29.09.2021 të cilët kanë hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, nga të cilat rezulton se kërkesëpadia e paditësit ngërthen në vete mbështetjen të mjaftueshme ligjore, dhe si e tillë duhet të trajtuar dhe vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj pagën e 13-të, për çdo vit duke filluar nga viti 2019, 2020 si dhe vitin 2021, për faktin se kjo kërkesëpadi gjen mbështetje në provat të cilat janë elaboruar më lartë si dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në nenin 29 par. 1 dhe par. 2 të udhëzimi i cili ka përcaktuar se: *“Neni 29 E drejta në pagë dhe e shpërblimit, par. 1. Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, ndërsa në par. 2 parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, mbi bazë të kësaj është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që bazohen në prova të qarta, të cilave gjykata iu fali besimin e plotë. Kështu që kërkesëpadia e paditësit e cila është aprovuar pjesërisht detyron të paditurën që paditësit që paditësit t'ia paguaj në ekuivalencë të një page mujore në lartësi prej një page mujore në lartësi prej 531.90 Euro, pagën e 13-të, për tre (3) vitet (2019, 2020, si dhe vitin 2021), në shumën e përgjithshme prej 1,595.70 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë më datë 23.12.2022.

Në harmoni me nenin 55 par.1 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, ku përcaktohet se: *“I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*, ndërsa në nenin 44 par. 2 të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*, në neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin*

2. të nenit 44 të këtij ligji”. Gjithashtu në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, i datës 21.01.2019 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*, ndërsa në pikën 2 të këtij paragrafi parashihet se: *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*. Ndërkaq në nenin 29 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, këto dispozita për gjykatën janë bazë e mjaftueshme ligjore prej të cilave rrjedh e drejta e paditësit për aprovimin e kërkesëpadisë së tij, për të cilin gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj, që të ia paguaj pagën e 13-të, për çdo fund vit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, i datës 14.11.2018, si dhe Udhëzimin Administrativ (UA) nr.01/2021 i datës 29.09.2021 ku me nenin 30 par. 2, më saktësisht, vlerësimi pozitiv ka qenë për vitet 2019, 2020, si dhe vitin 2021, ku ka qenë plotësisht i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata i pranoi si prova materiale dhe vendimtare provat e lartcekura, respektivisht kontratën e punës, vërtetimin si dhe formularët e lartcekur, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj vërtetimit me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit për vitet kalendarike 2019, 2020 dhe 2021, gjykata iu fali besimin e plotë, kështu që sipas vlerësimit të gjykatës, këto prova janë bazë e mjaftueshme ligjore prej të cilave rrjedh e drejta e paditësit për kompensimin e kërkesës së tij për të cilin gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të lartcekura dhe faktit se e paditura në bazë të udhëzimeve administrativ të nxjerr nga vetë ajo, gjykata vjen në përfundim se i njëjti prodhon efekt juridik për të gjithë të punësuarit në Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim e paditura ka

detyrim t'i përmbush kërkesa e të punësuarave të saj të cilat rrjedhin nga udhëzimi administrativ i nxjerr nga drejtori i përgjithshëm i policisë.

*Pjesa refuzuese e kërkesëpadisë.*

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit duke refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me refuzimin për shpërblimin e pagës së 13-të, për fund vitin 2022 ose shumën prej 531.90 euro, gjykata është bazuar në Udhëzimin Administrativ (UA) nr.01/2021 i datës 29.09.2021 ku me nenin 30 par. 2 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”* dhe gjithashtu është bazuar në Mendimin Juridik nr.213/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, ku në pikën -II- është paraparë se: *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës-lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”*, nga çka në mënyrë të drejtpërdrejtë ka përjashtuar pagesën e një page ekuivalente për vitin 2022 kjo për faktin se shprehimisht është përcaktuar deri në vitin 2021, kështu që pjesa e refuzuar e kërkesëpadisë së paditësit që përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2019 e deri më datën 31.12.2022, gjithsej 927 ditë pune, duke llogaritur nga 2.00 Euro, në shumë totale prej 1,854.00 Euro, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës), lidhur me kërkesën për pagesën shtesë që paditësi i ka kërkuar që të paguhet në ekuivalencë të një page mujore në lartësi prej 754.60 Euro, pagën e 13-të, për vitin 2022, diferenca në pagën e kërkuara shumen prej 222.70 Euro, si dhe në emër të një (1) pagave jubilarë për 10 vite përvojë pune shumën prej 754.60 Euro, në shumën e përgjithshme prej 3,585.90 Euro.

Sa i përket pjesës refuzuese për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtës), që përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2019 e deri më datën 31.12.2022, gjithsej 927 ditë pune, duke llogaritur nga 2.00 Euro, në shumë totale prej 1,854.00 Euro, ngase në shqyrtimin e



dispozitave ligjore rezultojn që shpërblimi i shujtës ditore është i karakterit deklarativ, sepse nuk përcakton detyrim konkret pasi që nuk përcaktohen kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës. Po ashtu, bazuar në nenin 30 par. 2 të UA 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, rezultojn se realizimi i shpërblimi është i kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore, derisa neni 29 par. 2 të UA 02/2018 i datës 14.11.2018 dhe i cili ka qenë në fuqi deri me datën 29.09.2021, ka qenë i karakterit detyrues dhe punëdhënësi është i obliguar që edhe për vitin 2021 të planifikoj mjetet buxhetore. Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesën e paditësit për kompensimin e shujtave ditore sepse me nenin 29 paragrafin 1 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, dhe pasi që kjo dispozitë ligjore nuk e detyron shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtës ditore ashtu siç ka kërkuar paditësi, gjykata vendosi si në pikën -III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe po ashtu duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik nr. 213/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se: *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës-lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021”*. Pra, duke u bazuar në të lartcekurat rezultojn se përfshirja e shpërblimit të shujtës ditore është e karakterit deklarativ dhe nuk përcaktojnë detyrime konkrete për punëdhënësin, por vetëm theksojnë se duhet të jenë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, gjithashtu nuk janë përcaktuar as kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës ditore.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune shumë prej 754.60 €), gjykata e refuzoj pasi që një kërkesë e tillë është e parashkruar duke u mbështetur në bazuar në nenin 341 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *“par. 1. Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit; par. 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka*

*mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit*”, lidhur me Ligjin nr. 03/L-212 të Punës, i cili përcakton në nenin e 87 se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, si dhe pasi që paditësi ka filluar punën 17.01.2005 dhe në vitin 2015 i ka bërë 10 vite përvojë pune ndërsa 20 vite përvojë pune i bënë në vitin 2025, prandaj nga të lartcekurat rezulton se kërkesëpadia për shpërblim jubilar është bërë pasi që kanë kaluar më shumë se 3 vite pasi që ka mbushur paditësi jubilen e parë (10 vite përvojë pune) ndërsa jubilen e dytë (20 vite përvojë pune) ende nuk i ka mbushur deri më datë 17.01.2025, e ketë gjykata e bazon në vërtetimin e punësimit të të paditurës të datës 02.12.2022 të lëshuar nga DRP Gjakovë, me nr. 04/01-08/SRR-NJBNJ-845/2022, nga e cila ka rezultuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën që nga data 17.01.2005, nga çka rezulton se deri në ditën e paraqitjes së padisë i njëjti kishte 17 vite përvojë pune dhe se gjykata nuk kishte si të vendoste ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të nenit 47 par. 4 të Ligjit nr. 04/L076 për Policinë, ku përcaktohet se: *“Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore”*, vlerëson se për të ju njohur e drejta për kompensim në shujta duhet të përcaktohet shprehimisht në ligj apo në aktet e brendshme nënligjore (që në rastin konkret nuk është përcaktuar shprehimisht me aktet nënligjore të të paditurës se personelit policor i takon e drejta e kompensimit në shujta ditore dhe lartësia e saj e shprehur në mjete monetare).

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Ndërsa, gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, për pjesën e refuzuar është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, lidhur me nenin 147 par. 1 të LPK-së, i cili thotë se: *“Në qoftë se prej disa kërkesëpadive, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit të mjaftueshëm, njëra ose disa sosh, janë pjekur për vendim definitiv dhe meritor apo në qoftë se vetëm pjesa e një kërkesë është pjekur për vendim meritor,*

*gjkata mundet, në pikëpamje të kërkesave të përgatitura, përkatësisht të pjesës së kërkesës së përgatitur, ta përfundoj shqyrtimin dhe ta jep aktgjykimin (aktgjykimi i pjesshëm)”.*

Kështu që bazuar në dispozitat e këtij neni gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë, ka bazë në dispozitat e Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë, Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, i datës 14.11.2018. si dhe nr. 01/2021 i datës 29.09.2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, si dhe Mendimin juridik për shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikim shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, i nxjerr nga Gjykata Supreme e Kosovës me nr. 213/2023 i datës 09.10.2023, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës si dhe dispozitat e lartcekura ligjore.

Sa i përket pretendimeve të palës së paditur se nuk janë shtjerrur mjetet e brendshme të ankimimit si dhe mungesës së mjeteve financiare, për gjykatën nuk kanë ndonjë impakt të cilat do të ndikonin që të vendosej ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitivin e këtij aktgjykimi, kjo pasi që vetë udhëzimi administrativ i nxjerrë nga drejtori i përgjithshëm i policisë në nenin 1 dhe 2 ka paraparë se: *“Me këtë udhëzim administrativ rregullohet marrëdhënia e punës për personelin e Policisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Policia) si: themelimi i marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëdhënia e punës, kriteret për punësim, procedurat e rekrutimit dhe seleksionimit, sistemimin dhe avancimin e punonjësve në vendet e punës, orarin e punës, paga, kompensimet, shtesat dhe beneficionet, pushimet, pezullimin, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe në neni 2 Fushë e zbatimit, ky udhëzim administrativ zbatohet për gjithë personelin e Policisë së Republikës së Kosovës”.*

Gjykata vendosi sikurse në dispozitivit të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (23.12.2022), si dhe në zbatim të Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat si dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 51 par. 1, nenin 87 të Ligjit të Punës, nenit 44 par. 2, nenit 47 par.4, nenit 55 par.1 nënpar. 1.7 të Ligjit për Policinë, nenit 1, 2, 5 par. 2 si dhe nenit 29 par. 1 dhe par. 2 të Udhëzimit Administrativ,

nenit 341 par. 1 dhe par. 2 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 329 par. 1, nenit 398 dhe nenit 399 par. 1, lidhur me nenin 147 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 449, nenit 452 si dhe nenit 453 par. 1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”,* dhe rregullores për tarifën e avokatëve, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë paditësit shumën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e që përfshijnë: për përpilim të padisë shumën prej 104.00 Euro, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 21.00 Euro, në shumën e përgjithshme prej 125.00 Euro, sipas TA (Tarifës së Avokatëve të Kosovës).

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA MALISHEVË,

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil,

C.nr. 1063/2022, më datë 11.10.2024.

Gj y q t a r i

Nehat Qelaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplar të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.